REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

# URDHËR

**Nr. 45, datë 5.3.2020**

**PËR**

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR TËRHEQJEN E DONACIONEVE NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për tërheqjen e donacioneve në kuadër të procesit të rindërtimit.

2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Z. Etjen Xhafaj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Znj. Rovena Voda, zëvendësministër i Brendshëm;
- Z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Z. Arjan Kraja, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Znj. Gelardina Prodani, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Z. Enea Hoti, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Znj. Ermelinda Dyrmishi, këshilltar i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Znj. Arta Dollani, drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës;
- Z. Alqi Kushi, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të jetë përgjegjës për caktimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, detyrave dhe për koordinimin e secilit prej anëtarëve.

4. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të autorizojë anëtarët që të bashkërendojnë dhe të koordinojnë me përfaqësuesit e shteteve e të organizatave donatore, sipas detyrave të përcaktuara nga Kryetari.

5. Të gjithë anëtarët të raportojnë në mënyrë periodike pranë Kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës.

6. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të informojë periodikisht Kryeministrin për ecurinë e gjithë procesit.

7. Ngarkohet Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit.

8. Ngarkohet grupi ndërinstitucional i punës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Znj. Ermelinda Dyrmishi, këshilltar i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Znj. Arta Dollani, drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës;
- Z. Alqi Kushi, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të jetë përgjegjës për caktimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, detyrave dhe për koordinimin e secilit prej anëtarëve.

4. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të autorizojë anëtarët që të bashkërendojnë dhe të koordinojnë me përfaqësuesit e shteteve e të organizatave donatore, sipas detyrave të përcaktuara nga Kryetari.

5. Të gjithë anëtarët të raportojnë në mënyrë periodike pranë Kryetarit të grupit ndërinstitucional të punës.

6. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës të informojë periodikisht Kryeministrin për ecurinë e gjithë procesit.

7. Ngarkohet Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit.

8. Ngarkohet grupi ndërinstitucional i punës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

NR.PROT. 1431/1
DATË 6. 3. 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE